

A e ndryshoi Kurti  
qëndrimin për  
Asociacionin? Çfarë  
thonë qytetarët? FAQE 5



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## GËRVALLA THOTË SE MODELI I RI I ASOCIACIONIT RESPEKTON KUSHTETUTËN E KOSOVËS. FAQE 4-5



Ministrja e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, ka thënë se modeli i ri i Asociacionit, i cili u është paraqitur, respekton Kushtetutën e Republikës sonë. "Një dokument i ri që kemi marrë, i cili nuk e di a do të quhet

asociacion apo si do të quhet, i cili shërben për implementimin e planit të lidhur në shkurt, i respekton shqetësimet, e respekton Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të gjitha dokumentet e tjera që sigurojnë funksionimin e

shtetit tonë", ka thënë ajo, duke shprehur se bashkësia ndërkombëtare do t'i shprehë sanksionet e duhura ndaj Serbisë me qëllim që të kemi një mundësi të lëvizjes për normalizimin e marrëdhënieve mes dy vendeve

### AKTUALE



**HARADINAJ: KOSOVA NUK MUND TË JETË PENG I DESTRUKTIVITETIT TË SERBISË, DUHET TA ZBATOJË PLANIN FRANKO-GJERMAN** F. 3

**VUÇIQI: TË GATSHËM TË PËRMBUSHIM GJITHÇKA QË NUK PËRFSHIN NJOHJEN DHE ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË OKB** F. 2

**VON DER LEYEN NIS VIZITËN KATËRDITORE NË BALLKANIN PERËNDIMOR, TË HËNËN NË KOSOVË** F. 3

### EKONOMI



**PARASHIKIMI PËR RITJE EKONOMIKE MUND TË PRISHT PAS LIBERALIZIMIT TË VIZAVE** F. 7

**ASK-ja: REGJISTRIMI I NËRMARRJEVE PUBLIKE, RITJE PREJ 4.8 %** F. 7

### SPORT



**BALLKANI DOMINON NË SUPERLIGË, GABOJNË DRITA DHE LLAPI** F. 10

**GJYSMA E  
JETËS NËN TOKË:  
MINATORËT  
KËRKOJNË KUSHTE  
MË TË MIRA** FAQE 3



**10 RASTE TË REJA ME  
HIV NË KOSOVË** FAQE 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fac: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji  
BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Vuçiçi: Të gatshëm të përmbushim gjithçka që nuk përfshin njohjen dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB

BEOGRAD, 29 TETOR - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, tha për televizionin "Prva" të Serbisë se afatet kohore për një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë më nuk kanë asnjë kuptim dhe se Serbia është e gatshme të përmbushë gjithçka që nuk përfshin njohjen e Kosovës dhe anëtarësimin e saj në Kombet e Bashkuara.

Gjermania, Franca dhe Italia kanë kërkuar që Beogradi ta njohë de facto pavarësinë e Kosovës dhe që Kosova ta formojë Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Kështu është thënë në letërën e nënshkruar nga kancelari gjerman Olaf Scholz, presidenti francez Emmanuel Macron, dhe kryeministria italiane Giorgia Meloni.

Kjo letër vjen pasi liderët e tri shteteve kyçe të Bashkimit



Evropian zhvilluan takime të ndara me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiç, në Bruksel më 26 tetor. "Unë u thashë që ne jemi të gatshëm t'i zbatojmë [marrëveshjet], por thashë se për këtë nuk jemi pajtuar", tha Vuçiçi,

duke shtuar se ka refuzuar t'i nënshkruajë dokumentet e ofruara. "U thashë se ne e kemi Kushtetutën e Serbisë", tha ai. Vuçiçi, po ashtu, tha se nuk ka kërkuar të pranohet asnjë letër anësore.

Pas takimeve në Bruksel, Zyra e Kurtit tha se kryeministri ka

refuzuar të pranojë një letër anësore të paraqitur nga Vuçiçi që, sipas Qeverisë së Kosovës, zhbën tri parimet e Marrëveshjes drejt normalizimit të raporteve, Anekstit të saj dhe draftit të propozuar nga pesë emisarët që vizituan Kosovën dhe Serbinë më 21 tetor. "Unë thashë se ne jemi të gatshëm t'i përmbushim obligimet tona dhe shtova se ne nuk mund të pranojmë asgjë që lidhet me njohjen e pavarësisë së Kosovës apo anëtarësimin e saj në OKB", tha Vuçiçi.

Ai shtoi se ka dëgjuar për disa afate kohore për një marrëveshje në mes të Kosovës dhe Serbisë për më shumë se dhjetë vjet dhe më ato nuk kanë kuptim.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, tha më 27 tetor se ishte i gatshëm të nënshkruante një marrëveshje për normalizimin e raporteve dhe propozimin për

formimin e Asociacionit, por shtoi se "pala serbe nuk ishte e interesuar".

Takimet e ndara në Bruksel të bartësve të dialogut me liderët kyç evropianë përfunduan pa asnjë rezultat.

Kosova ka thënë se propozimi evropian për një draft-statut për themelimin e Asociacionit "është shkruar me kujdes" ndaj Kushtetutës së Kosovës.

Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Po më 2015 Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën.

Serbia kërkon që Kosova t'i zbatojë marrëveshjet e arritura, por Qeveria e Kosovës është deklaruar kundër një asociacioni njëetnik.

## Ministria e Shëndetësisë në Gazë: Numri i viktimave ka arritur mbi 8 000

GAZA, 29 TETOR - Ministria e Shëndetësisë në Gazën e udhëhequr nga Hamasi tha se numri i palestinezëve të vrarë që kur nisi lufta me Izraelin më 7 tetor ka kaluar shifrën prej 8 000. Kjo ministri tha të dielën se numri i palestinezëve të vrarë ka arritur në 8 005, përfshirë mbi 3 300 të mitur dhe mbi 2 000 gra. Ministria e Shëndetësisë në Gazë është pjesë e qeverisë që udhëhiqet nga Hamasi, po ashtu përfshin mjekë dhe shërbyes civilë që nuk janë të lidhur me grupin.

Numri i viktimave që nga nisja e luftës kalon numrin e viktimave që janë regjistruar nga Kombet e Bashkuara, madje edhe nga vlerësimet e Izraelit. Ministria e Shëndetësisë në Gazë javën e kaluar publikoi emrat dhe moshën e shumicës së viktimave të regjistruara dhe tha se disa nga trupat e pajetë ende nuk janë identifikuar.

Mbi 1 400 persona janë vrarë në Izrael, shumica civilë, gjatë

sulmit të Hamasit në Izrael më 7 tetor. Që atëherë, Izraeli ka sulmuar nga toka, ajri dhe deti Rripin e Gazës, ku jetojnë 2.3 milionë palestinezë.

### Palestinezët hyjnë nëpër depo për t'u furnizuar me ushqime

Agjencia e Kombeve të Bashkuara për refugjatët palestinezë tha se mijëra persona kanë hyrë me forcë në depo të ndihmës në Gazë për të marrë ushqime dhe "gjësende të tjera elementare për mbijetesë".

Thomas White, drejtor i agjencisë në Gazë, tha më 29 tetor se kjo hyrje në depot e ushqimeve "është një shenjë shqetësuese se rendi civil ka filluar të priset" pas tri javësh luftë në mes të Izraelit dhe Hamasit, që udhëheq Gazën.

Agjencia, që njihet si UNRWA, ofron shërbime bazike për qindra mijëra persona në Gazë.



Shkollat që udhëhiqen nga kjo agjenci në mbarë Rripin e Gazës janë shndërruar në strehimore për palestinezët e zhvendosur nga konflikti.

Gaza është e rrethuar dhe po përballet me sulme të

vazhdueshme ajrore, detare dhe tokësore nga Izraeli, që kur Hamasi kreu sulm në Izrael më 7 tetor, duke vrarë mbi 1 400 persona.

Izraeli ka bllokuar furnizimet me karburante, ujë dhe rrymë për në

Gazë, ku jetojnë 2.3 milionë palestinezë. Autoritetet izraelite kanë lejuar vetëm një pjesë të vogël të ndihmës për palestinezët që ka hyrë nga pikëkalimi Rafah, që lidh Gazën me Egjiptin.

## Ish-nënpresidenti Pence ndërpret fushatën presidenciale

Uashington, 29 tetor - Ish-nënpresidenti Mike Pence ndërpreu të shtunën garën për emërimin si kandidat për president i Partisë Republikane, duke i dhënë fund fushatës për Shtëpinë e Bardhë pas vështirësive për të mbledhur fonde dhe fituar mbështetje. "Kam vendosur ta pezulloj fushatën time për

president në fuqi sot", tha Pence në mbledhjen e Koalicionit Republikan Hebre në Las Vegas. "Që në fillim e kemi ditur se kjo do të ishte një betejë e vështirë, por nuk jam penduar", tha ai.

Ai bëhet kandidati i parë me peshë që tërhiqet nga gara që është mbizotëruar nga ish-presidenti Donald Trump.

Tërheqja është një humbje e madhe për një politikan që gjatë gjithë mandatit të ish-presidentit Trump i shërbeu atij me besnikëri, vetëm për t'u vënë në shënjestër nga Trumpi gjatë ditëve të fundit në detyrë, kur ai pretendoi se Pence kishte kompetencën t'i përmbyste rezultatet e zgjedhjeve të 2020-s, që nuk ishte e vërtetë.



## Deputetja britanike i bën thirrje BE-së t'i largojë sanksionet ndaj Kosovës



PRISHTINË, 29 TETOR - Deputetja britanike Alicia Kearns ka reaguar ndaj deklaratës së presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, i cili tha se nuk mund të "pranojmë asgjë që lidhet me njohjen e Kosovës apo

anëtarësimin në OKB". Deputetja Kearns në platformën "X" ka kërkuar heqjen e sanksioneve ndaj Kosovës, duke thënë se Vuçiqi refuzon të punojë me komunitetin ndërkombëtar. "Edhe një herë Kosova

punon me komunitetin ndërkombëtar, përkundër një sulmi terrorist të orkestruar nga Beogradi. Edhe një herë Vuçiqi refuzon. Hiqini sanksionet ndaj Kosovës, tani Josep Borrell dhe Ursula von der

Leyen", ka shkruar Kearns. Gjermania, Franca dhe Italia i kanë kërkuar Beogradit që de facto ta njohë pavarësinë e Kosovës dhe nga Kosova të formojë një komunitet komunash me shumicë serbe në Kosovë.

## Haradinaj: Kosova nuk mund të jetë peng i destruktivitetit të Serbisë, duhet ta zbatojë planin franko-gjerman

Prishtinë, 29 tetor - Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, është shprehur se Kosova nuk mund të jetë peng i destruktivitetit të Serbisë, por ta vazhdojë perspektivën e saj që është anëtarësimi në NATO dhe integrimi në BE. "Kosova në vazhdimësi ka dëshmuar se është pro vlerave perëndimore dhe euroatlantike dhe gjithnjë konstruktive në qasjen e saj

për të arritur një marrëveshje përfundimtare për njohje të ndërsjellë me Serbinë. Serbia nga ana tjetër në vazhdimësi ka sabotuar përpjekjet për një marrëveshje të qëndrueshme paqeje midis dy vendeve duke synuar ta rikthejë kohën e konfliktit. Nuk ka asnjë dyshim se këtë kurs po e ndjek edhe sot", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Ai ka theksuar se Kosova në

një situatë të tillë, pa e pasur nevojën të dëshmojë sa e keqe është Serbia, duhet ta ndjekë kursin e saj euroatlantik dhe t'i përmbushë obligimet e marra, duke zbatuar pa vonesë planin franko-gjerman. "Kosova nuk mund të jetë peng i destruktivitetit të Serbisë, por ta vazhdojë perspektivën e saj që është anëtarësimi në NATO dhe integrimi në BE", ka shkruar lideri i AAK-së.



## Von der Leyen nis vizitën katërditore në Ballkanin Perëndimor, të hënën në Kosovë



PRISHTINË, 29 TETOR - Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, të dielën ka nisur një vizitë katërditore në Maqedoninë e Veriut, Kosovë, Mal të Zi, Serbi dhe Bosnjë-Hercegovinë. Presidentja e KE-së të dielën është takuar me presidentin e Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski. Më pas me kryeministrin e Maqedonisë së Veriut, Dimitar Kovačevski, në Shkup. Pastaj ka udhëtuar për në Prishtinë, ku të hënën pritet të takohet me presidenten dhe

kryeministrin e Kosovës, Vjosa Osmani dhe Albin Kurti. Në një komunikim për medie theksohet se ky do të jetë një rast për ta diskutuar bashkëpunimin dypalësh, veçanërisht për t'ua paraqitur më në detaje udhëheqësve rajonalë planin e rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor. Të martën në mëngjes presidentja e KE-së do të jetë në Podgoricë të Malit të Zi, ku do të takohet me presidentin Jakov Milatović dhe kryeministrin në detyrë të Malit të Zi, Dritan Abazović.

Po të martën Von der Leyen do të udhëtojë për në Beograd, ku do të takohet me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq dhe kryeministrin Ana Brnabić. Në ditën e fundit, të mërkurën, ajo do të takohet në Sarajevë me Presidencën e Bosnjë-Hercegovinës dhe me kryetaren e Këshillit të Ministrave, Borjana Kristo. Vizita në Ballkanin Perëndimor vjen pas pjesëmarrjes së von der Leyen në Samitin e Procesit të Berlinit të mbajtur në Tiranë më 16 tetor.

## Kurti mori pjesë në sesionin hapës të Nivelit Teorik të Shkollës Politike të LV-së

Prishtinë, 29 tetor - Të dielën Lëvizja Vetëvendosje ka mbajtur sesionin hapës të Nivelit Teorik të Shkollës Politike për vitin 2023-2024, ku aktivistët u pritën nga kryeministri, njëherësh kryetari i LV-së, Albin Kurti, nënkryetarja Mrika Limani -Myrtaj dhe aktivistët Liridona Kelani dhe Hazir Asllani. Në fjalën hapëse të diskutimit për këtë sesion, Kurti ka folur për rëndësinë e shkollës si platformë ku aktivistët mund të mësojnë e diskutojnë për konceptet më të rëndësishme politike dhe filozofike.

Kjo u tha në kontekst të diskutimit që aktivisti politik duhet t'i ketë këto dije të formuara në mënyrë që puna e aktivistëve politikë të LV-së të mos jetë një reaksion kuturu i antagonizmit politik, por një kundërshtim i zëshëm për hir të parimeve dhe kundër padrejtësive. Në njoftimin e LV-së theksohet se Shkolla Politike është vend i filozofisë politike për aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje, ku mbahet gjallë elani për aktivizim politik e bashkëdyzohen aktivizmi dhe teorikja. "Shkolla

Politike është tregues i seriozitetit me të cilin trajtohet thelbi i formimit politik me ide e parime që dëshmojnë se politikën e sferës publike nuk e konsiderojmë rrymë për lëvizje inerte. Ne kemi ide të artikuluar, parime të palëkundura, aktivizmin si mjet dhe barazinë si qëllim. Niveli Teorik i Shkollës Politike do të zgjasë për një vit akademik. Aktivistët do të ndjekin ligjërata për filozofinë politike, shkencat politike e historinë dhe ekonominë politike", thuhet në njoftimin e LV-së.





## Gërvalla thotë se modeli i ri i Asociacionit respekton Kushtetutën e Kosovës

Ministrja e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, ka thënë se modeli i ri i Asociacionit, i cili u është paraqitur, respekton Kushtetutën e Republikës sonë. “Një dokument i ri që kemi marrë, i cili nuk e di a do të quhet asociacion apo si do të quhet, i cili shërben për implementimin e planit të lidhur në shkurt, i respekton shqetësimet, e respekton Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të gjitha dokumentet e tjera që sigurojnë funksionimin e shtetit tonë”, ka thënë ajo, duke shprehur se bashkësia ndërkombëtare do t’i shprehë sanksionet e duhura ndaj Serbisë me qëllim që të kemi një mundësi të lëvizjes për normalizim të marrëdhënieve mes dy vendeve

PRISHTINË, 29 TETOR - Javën që lamë pas në Bruksel, pas takimit me udhëheqësit e Bashkimit Evropian dhe presidentin e kryeministrin e Francës, të Gjermanisë dhe të Italisë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, shprehu gatishmërinë ta nënshkruajë projektin e ofruar nga diplomatët perëndimorë për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ndërkohë që akuzoi presidentin serb për mosgatishmëri për ta zbatuar marrëveshjen e njohur si plani franko-gjerman. Në një koment për “Zërin e Amerikës”, Departamenti i Shtetit tha se procesi i normalizimit i ndërmjetësuar nga BE-ja është

rruga e vetme për të siguruar marrëdhënie paqësore dhe produktive dhe për t’i realizuar aspiratat e dy vendeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian. ShBA-ja përsëriti thirrjen që dy palët të angazhohen seriozisht dhe urgjentisht drejt këtij qëllimi dhe t’i zbatojnë plotësisht të gjitha angazhimet që dalin nga dialogu. Në një intervistë për “Zërin e Amerikës”, ministrja e Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla, tha se marrëveshja duhet të zbatohet e gjitha. Ajo ka theksuar se një zbatim i pjesshëm nuk do ta sillte përparimin e synuar. Ajo ka thënë se modeli i ri i Asociacionit, i cili u

është paraqitur, respekton Kushtetutën e Republikës sonë. “Një dokument i ri që kemi marrë, i cili nuk e di a do të quhet asociacion apo si do të quhet, i cili shërben për implementimin e planit të lidhur në shkurt, i respekton shqetësimet, e respekton Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe të gjitha dokumentet e tjera që sigurojnë funksionimin e shtetit tonë. Si institucione të përgjegjshme, minimumi i asaj që kërkojmë me çfarëdo lloj propozimi që na vjen është respektimi i shtetësisë, i sovranitetit, i Kushtetutës së Republikës. Mendoj se ky është

detyrim i çdo qeverie të çdo vendi demokratik”, ka thënë Gërvalla. Ajo shprehur që bashkësia ndërkombëtare ta ushtrojë tryshinë e duhur, t’i shprehë sanksionet e duhura ndaj Serbisë me qëllim që të kemi një mundësi të lëvizjes për normalizimin e marrëdhënieve tona. “24 shtatori ka treguar që Kosova ka pasur të drejtë, që Serbia ndërkohë që ne përpiqeshim të arrinim rezultate në dialog, ka qenë duke përgatitur trupa paramilitare për t’i dërguar në Kosovë për ta pushtuar territorin e Kosovës, prandaj ne shpresojmë që bashkësia ndërkombëtare më në fund të jetë më e vendosur në kërkesat e saj për dënimin e agresorit, por edhe për kërkimin e rrugëve të cilat mundësojnë një zgjidhje afatgjatë”, ka thënë ministrja Gërvalla. Në pyetjen se para sulmit të 24 shtatorit qeveria juaj ka kritikuar komunitetin ndërkombëtar për presion të padrejtë ndaj Kosovës sesa ndaj Serbisë, a keni vërejtur ndonjë qëndrim ndryshe të Bashkimit Evropian dhe në tërësi të bashkësisë ndërkombëtare që atëherë?, Gërvalla është përgjigjur: “Mendoj që jo vetëm qeveria jonë,

por edhe shumë vëzhgues të proceseve në Ballkan, shumë studiues, shumë gazetarë, medie serioze kanë kritikuar qasjen e Bashkimit Evropian si të njëanshme në raport me Kosovën dhe në kërkesën në vazhdimësi që Kosova të bëjë lëvizje të mëdha ndërkohë që ka pasur njëfarë mirëkuptimi të vazhdueshëm për Serbinë, e cila jo vetëm në rastin e Kosovës nuk lëviz, por nuk përpiqeshim të arrinim rezultate në dialog, ka qenë duke përgatitur trupa paramilitare për t’i dërguar në Kosovë për ta pushtuar territorin e Kosovës, prandaj ne shpresojmë që bashkësia ndërkombëtare më në fund të jetë më e vendosur në kërkesat e saj për dënimin e agresorit, gjithashtu edhe për kërkimin e rrugëve të cilat mundësojnë një zgjidhje afatgjatë”.

# A e ndryshoi Kurti qëndrimin për Asociacionin? Çfarë thonë qytetarët



PRISHTINË, 29 TETOR - Qytetarët e Kosovës kanë komentuar qëndrimin e kryeministrit Albin Kurti lidhur me gatishmërinë e tij për ta nënshkruar propozimin e diplomatëve evropianë për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë e për të cilin dikur thoshte se nuk do të formohej kurrë.

Një takim tjetër në mes të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, dhe presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, përfundoi pa ndonjë rezultat konkret në Bruksel. Ata patën deklarata të kundërta pas takimeve që ata zhvilluan ndaras me diplomatët evropianë.

Derisa Qeveria e Kosovës tha se ishte e gatshme ta nënshkruante propozimin e diplomatëve evropianë për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë, Vuçiqi insistoi në zbatim të marrëveshjeve të kaluara.

Kurti tha se në takimin me emisarët amerikanë dhe evropianë është thënë nëse nënshkruhet drafti për vetëmenaxhim, do të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese për t'u vlerësuar kushtetutshmëria.

Në konferencën për medie, Kurti tha se në takimin që u mbajt më 27

tetor në Bruksel ka rikujtuar se më 27 shkurt është pranuar marrëveshja bazike dhe aneksi i zbatimit në Ohër më 18 mars me 12 pikat e tij. Sipas tij, nëse do të nënshkruhej, do të vlerësohej nga Kushtetuesja.

Për këtë çështje janë deklaruar edhe qytetarët, se si e vlerësojnë këtë hap të tij, dhe nëse i ka ndryshuar Kurti qëndrimet karshi deklaratave të mëhershme se nuk do të ketë kurrfarë asociacioni për serbët.

Hasan Ismaili thotë për "KosovaPress" se Kurti çdo gjë e bën për të mirën e Kosovës, dhe se nuk bën gabime si të tjerët. Ndërsa qytetari Selim Limani tha se ka qenë e ditur, që nuk ka zgjidhje tjetër përpos që ta nënshkruajë themelimin e asociacionit, por pala serbe është duke kundërshtuar. Për më tepër, Limani ka komentuar edhe deklaratimet e mëhershme të Kurtit se në Kosovë asnjëherë nuk do të ketë asociacion për serbët.

Ndërsa Enver Ukaj thotë se njohja nga Serbia mbetet gjëja më kryesore, pasi kështu po mbetet në konflikt me Kosovën.

Ndërkaq, Gjimi nga Presheva thotë se problemi është se presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, nuk po e

nënshkruan draft-dokumentin e BE-së për asociacionin, pasi kërkon që ai të ketë kompetenca ekzekutive. Sipas tij, serbët me sulmin terrorist të 24 shtatorit në Banjaska të Zveçanit dëshiruan ta aneksojnë veriun dhe ta shpallin asociacionin me kompetenca ekzekutive.

Ndërkohë, të dielën ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, i ka reaguar opozitës lidhur me gatishmërinë e kryeministrit Kurti për ta nënshkruar draftin e asociacionit të propozuar nga BE-ja. "Dyfytyrësi e thellë opozitare. 'E pranuat asociacionin pa njohje' po na thonë të njëjtit që atë e nënshkruan dy herë dhe e ratifikuan në Kuvend. Në këmbim të asgjëje. E gjatë dhe e mundimshme do të jetë rruga për sanimin e dëmeve që ia keni shkaktuar Republikës, por nuk do të heqim dorë", ka shkruar ai në "Facebook".

Nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku, e ka quajtur turp deklaratën e ministrit Çeku. "Ministri i Kulturës thotë se opozita qenka dyfytyrëse që po e kritikon pushtetin pas pranimit të asociacionin. Kritika është për dhunën, bombat, sharjet, lotsjellësin, vitet e humbura, dhe

vdekjet që u shkaktuan nga kundërshtimi i një marrëveshje, të cilën sot VV e pranon në një version shumë më të dobët. Turp", ka shkruar Çitaku në "Facebook".

Pa ndonjë përparim, Kosova dhe Serbia përmbyllën edhe një maratonë takimesh të enjten në Bruksel. Sipas udhëheqësve të BE-së, arritjen e pajtimit e penguan kushtëzimet që paraqitën palët. Kurti tha se vetëm nënshkrimi i marrëveshjeve me vendin fqinj garanton zbatimin e tyre, ndërsa Vuçiqi këmbënguli në zbatimin e "asaj që është nënshkruar".

Shefi i politikës së jashtme i BE-së, Josep Borrell, i cili ndërmjetëson bisedimet për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi, tha se marrëveshja mes tyre nuk ishte e mundur, sepse "parakushtet e njëjës palë ishin të papranueshme për tjetrën".

Temë e diskutimeve në Bruksel ishte propozimi i ri i diplomatëve perëndimorë për statutin e asociacionit serb, i cili u paraqit në Prishtinë e Beograd më 21 tetor.

Pas takimeve që Kurti zhvilloi me udhëheqësit evropianë, ai përsëriti se është i gatshëm ta nënshkruajë Marrëveshjen Bazë për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë, si dhe draftin e ofruar nga

diplomatët perëndimorë për themelimin e asociacionit, por se pala tjetër nuk është. "Presidenti i Serbisë, Vuçiq, ka refuzuar të nënshkruajë marrëveshje me Kosovën dhe ka kërkuar që t'i pranohet një letër anësore, me të cilën praktikisht i zhbën tri parime të Marrëveshjes Bazë, të Aneksit të Zbatimit, si dhe të draftit të propozuar nga pesë emisarët më 21 tetor 2023", tha ai.

Kosova e Serbia kanë arritur marrëveshjen bazë për normalizimin e marrëdhënieve në muajin shkurt në Bruksel, ndërsa për Aneksin e Zbatimit të saj janë pajtuar në muajin mars në Ohër. Në asnjërin prej dokumenteve palët nuk i kanë vendosur nënshkrimet. Kurti tha se edhe atëkohë ka qenë i gatshëm të nënshkruajë.

Autoritetet në Prishtinë theksojnë se çdo iniciativë që është në kundërshtim me Kushtetutën nuk do të pranohet, ndërsa Serbia kërcënon se nuk do t'i zbatojë marrëveshjet e arritura në dialog nëse nuk nis puna për zbatimin e ujdisë. ShBA-ja dhe BE-ja kërkojnë me ngulm nisjen e punës për përmbyshjen atij që e quajnë një detyrim për Kosovën dhe garantojnë se asociacioni nuk do të jetë një shtet brenda shtetit.

# Gjysma e jetës nën tokë: Minatorët kërkojnë kushte më të mira

PRISHTINË, 29 TETOR - Tash e 38 vjet punën e fillon në terr dhe e mbaron kryesisht në terr. Eset Meha, 62 vjeç, është kryepunëtor në kombinatin metalurgjik "Trepça", sektorët e të cilit gjenden në jug dhe në veri të Mitrovicës.

Çdo ditë pune ai futet 740 metra nën tokë, në horizontin e dhjetë të minierës. Me uniformë të vjetruar, çizme të baltosura e helmetë të zymtuar, thotë se punon në ajër të ndotur, tym e lagështi. "Puna më ka bërë që gjatë fjetjes të kem probleme me frymëmarrje", thotë ai. "Në minierë kam punuar në vende të ndryshme. Nuk është aspak lehtë. Çdo minator i 'Trepçës', nëse del në pension i shëndoshë, duhet t'i falënderohet Zotit", thotë Meha gjatë një bisede me "Radion Evropa e Lirë", të realizuar në thellësi të minierës ku punon.

I punësuar nga viti 1985, ai thotë se gjithmonë është i vetëdijshëm për rreziqet dhe pasiguritë që i ka puna e minatorit, porse me pagën nuk është i kënaqur. "Me të nuk mund ta kaloj muajin", thotë Meha, i cili me familjen shtatanëtarëshe jeton në fshatin Broboniq të Mitrovicës së Jugut. "Në dy vitet e fundit ka pasur rritje të çmimeve. Nëse më herët kam blerë sasi më të mëdha dhe llojlojshmëri të produkteve ushqimore, tash blej sasi dhe lloje më të pakta", thotë ai. Pagat e minatorëve në "Trepçë" sillen nga 700 deri në 900 euro, varësisht përvojës dhe përgatitjes profesionale. Por, ata nuk kanë pasur kurrë as sigurime shëndetësore, as jetësore dhe vazhdimisht kanë kërkuar të tilla. "Vetëm për të hyrë dhe për të dalë nga miniera, me pajisje të



vjetra, ato na takojnë... e lëre më për punën e vështirë që bëjmë", thotë Meha.

Pikërisht për shkak të kushteve në punë, ai thotë se nuk i ka sugjeruar asnjërit prej tre djemve të tij që t'ia trashëgojë profesionin.

Por, Alban Ferati, 35 vjeç, thotë se ka së paku kontratë pune. Ai ka katër vjet që është punësuar në minierën e "Trepçës", pas viteve të pasigurisë në sektorin privat, siç shprehet. Edhe ai thotë se paga që merr, prej 800 eurosh, është e pamjaftueshme. "Edhe atë nuk na e japin me rregull. Muajt e fundit po e ndajnë në dy pjesë", thotë babai i tre fëmijëve. Përveç për detyrime familjare, ai thotë se pagën i duhet ta shfrytëzojë nganjëherë edhe për të blerë pajisje për punë,

sidomos çizme. "Shpesh ndodh që të kërkoj hua te ndonjë koleg apo familjar për ta përmbyllur muajin. Çmimet janë rritur shumë", thotë Ferati.

Ai thotë se kollitja dhe kokëdhimbja i janë bërë normale si pasojë e tymit të zi dhe ajrit të rëndë në minierë. "Temperaturat janë deri në 40 gradë celsius, verë e dimër", thotë ai, duke shtuar si siguri shëndetësor duhet të ofrohet medoemos. "Nuk ka punë më të vështirë dhe më të rrezikshme se ajo e minatorit. Për këtë arsye, në hyrje të minierës shkruan 'Me fat!...', shprehet Ferati.

Të pakënaqur me kushtet e punës, Meha dhe Ferati, së bashku me rreth 200 kolegë të tjerë, janë futur në grevë që nga 24 tetori.

Duke qëndruar në ambiente të ndryshme nën tokë, por duke mos punuar, ata kërkojnë realizimin e pagës mujore me kohë, sigurimin shëndetësor dhe shkarkimin e menaxhmentit të "Trepçës", të cilin e fajësojnë për, siç thonë, kushtet jo të mira. Menaxhmenti nuk është prononcuar në lidhje me grevën. Por, në një komunikatë për medie, Ministria e Ekonomisë e Kosovës ka thënë se minatorët duhet t'i kthehen punës. "Gjatë këtij viti pagat e minatorëve janë rritur për 17 për qind, mëditja për punë shtesë është rritur për 23 për qind dhe shujta pothuajse është dyfishuar", ka thënë kjo ministri.

Gani Osmani, përfaqësues i Sindikatës së Punëtorëve të Trepçës, thotë se grevistët janë të

vendosur të mos punojnë deri në realizimin e kërkesave. "Paga nuk është reale. Toka dhe nëntoka kanë dallim. Gjysmën e jetës e kalojmë në terr. Kështu duhet të jetë edhe dallimi në paga, si dita me natën", thotë Osmani, duke shtuar se paga e minatorëve duhet të jetë "shumë më e lartë se e punonjësve në sektorë të tjerë mbi sipërfaqe të tokës".

Kompleksi metalurgjik "Trepça" është shoqëri aksionare: 80 për qind e aksioneve janë të Qeverisë së Kosovës, 20 për qind janë të punonjësve të kësaj ndërmarrjeje.

Deri në vitet '90, kur është përkeqësuar situata politike, ajo është llogaritur si një prej ndërmarrjeve më të mëdha jo vetëm në Kosovë, por edhe në territorin e Jugosllavisë së atëhershme. Me rreth 20 000 punëtorë, është cilësuar si shtylla kryesore e ekonomisë së Kosovës dhe ish-Jugosllavisë. Sot i ka rreth 700 minatorë.

Deri në periudhën para vitit 1990 nga minierat e "Trepçës" janë nxjerrë rreth 600 mijë tonë xehe në vit. Rënia e prodhimit ka nisur në vitet '90, kur regjimi i atëhershëm i Serbisë ka vendosur masa të dhunshme në Kosovë, duke mbyllur gati të gjitha ndërmarrjet dhe institucionet në vend. Por, "Trepçën" e kanë përcjellë probleme edhe pas përfundimit të luftës në Kosovë më 1999. Makineritë e vjetruara mbi 50 vjet dhe mungesa e mirëmbajtjes janë shndërruar në probleme të vazhdueshme. Grevat e minatorëve, po ashtu, rikthehen kohë pas kohe. "Ne e dimë kur hyjmë në minierë, por nuk e dimë a mund të dalim", thotë Ferati, minator 35-vjeçar.

## 10 raste të reja me HIV në Kosovë

PRISHTINË, 29 TETOR - Numri i të prekurve me HIV të regjistruar në Klinikën Infektive që nga janari e deri tash është 10 raste të reja, por ka informata që ka edhe raste të tjera të reja që pritet të vijnë. Kështu ka bërë me dije shefi i Repartit të HIV-it në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), Murat Mehmeti, derisa thotë se ky numër pritet të rritet në vazhdimësi.

Mehmeti tha se, sipas informacioneve të marra nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, numri i rasteve të prekura me HIV është më i madh sesa që është i evidentuar. "Sa iu përket rasteve të regjistruara në klinikën tonë, deri në këto momente kur po flasim, i kemi të regjistruara 10 raste të reja prej janarit deri më tani. Kam informata që ka edhe raste të tjera të reja që pritet të vijnë.



Ndërkohë, sipas informatave që i kam nga Institutit

Kombëtar i Shëndetit Publik, numri i rasteve është më i

madh sesa që ne i kemi në evidencën tonë, sepse në

Klinikën Infektive vijnë rastet kur ata vendosin të trajtohen apo të marrin terapi nga klinika jonë. Mirëpo, gjithmonë ndodh që të ketë edhe raste të cilat, edhe pasi të identifikohen si HIV pozitiv, për një arsye ose tjetër, mund të mos vijnë që ta vazhdojnë trajtimin në Klinikën Infektive", tha Murati. Profesionisti shëndetësor ka potencuar se aktualisht një pacient i prekur nga HIV-i është i shtrirë në Klinikën Infektive, i cili po merr trajtim mjekësor. Ai shtoi se homoseksualët janë komuniteti më i prekur nga ky virus.

Murati shtoi se moshat më të prekura nga HIV janë ata 20 deri në 25 vjeç dhe që kryesisht i takojnë gjinisë mashkullore. Ai ka theksuar se ky repart ka mungesë të stafit të mesëm, derisa potencoi se qëndrojnë mirë sa i përket furnizimit me barna esenciale. (ksp)

# Parashikimi për rritje ekonomike mund të priset pas liberalizimit të vizave



**PRISHTINË, 29 TETOR** - Banka Qendrore e Kosovës, Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar parashikojnë rritje ekonomike në Kosovë deri në 4 për qind vitin e ardhshëm. Parashikimi është më pozitiv krahasuar me 3.5 për qind këtë vit dhe po aq vitin e kaluar. Nga BQK-ja thonë se ai u atribuohet pritjeve për rritje të konsumit dhe investimeve si dhe për stabilizim të çmimeve. Ekspertët të ekonomisë dhe përfaqësues të bizneseve, në anën tjetër, paralajmërojnë se parashikimi mund të mos dalë i saktë nëse ka ikje masive të qytetarëve pas liberalizimit të vizave me vendet evropiane, nga 1 janari i vitit 2024. Në një deklaratë me shkrim dhënë "Radio Evropa e Lirë", Departamenti për Marrëdhënie me Jashtë të BQK-së thotë se dukuria e emigrimit ka ndikim potencial në tregun e punës dhe, rrjedhimisht, në gjithë aktivitetin ekonomik. Sipas BQK-së, përkeqësimi i këtij trendi me lëvizjen e lirë të qytetarëve pas janarit të vitit 2024 "do të përkthehet në debalancë të

tregut të punës dhe dobësim të performancës së bizneseve dhe dinamikave të përgjithshme makroekonomike në vend". Por, thonë në BQK, ritmin e aktivitetit ekonomik mund ta ndikojnë edhe faktorë të tjerë, si: pasiguritë e vazhdueshme gjeopolitike, kërkesa e jashtme më e dobët apo përkeqësimi i kushteve tregtare. Në raportin ekonomik për Ballkanin Perëndimor të Bankës Botërore, të publikuar më 19 tetor, thuhet se në Kosovë, ndonëse parashikimet për rritje ekonomike mbeten pozitive, rreziqet për ngadalësim janë domethënëse. Ato ndërlihen me pasiguritë e vazhdueshme nga lufta në Ukrainë dhe pasojat që mund t'ia shkaktojë ajo aktivitetit ekonomik në Evropë. Në një deklaratë dhënë "REL"-it, nga Banka Botërore thonë se gjatë vitit 2022 tregu i punës në Kosovë është karakterizuar me tkurrje të popullsisë në moshë pune, "me gjasë për shkak të migrimit të vazhdueshëm". Por, sipas tyre, Kosova ka potencial të madh të pashfrytëzuar të fuqisë punëtore, marrë parasysh

shkallën e lartë të mospjesëmarrjes në tregun e punës, veçanërisht në mesin e grave. "Migrimi mund të ushtrojë presion për paga më të larta dhe, në të njëjtën kohë, kjo mund t'i nxjerrë më shumë qytetarë nga mospjesëmarrja në tregun e punës", thonë nga Banka Botërore. Në Fondin Monetar Ndërkombëtar nuk iu përgjigjen kërkesës së "REL"-it për t'i komentuar parashikimet për rritje ekonomike dhe rreziqet që mund t'i përcjellin ato.

## Lëvizja e lirë do të marrë punëtorë

Eksperti i çështjeve ekonomike, Ismet Mulaj, i cili në të kaluarën ka shërbyer edhe si ministër i Tregtisë dhe Industrisë në Kosovë, thotë se me liberalizimin e vizave mijëra qytetarë mund ta lënë Kosovën. Ata, thotë Mulaj, do të shkojnë për vizita në vende të ndryshme të BE-së, por disa edhe mund të lidhin kontrata pune e më pas të pajisen edhe me viza pune. "Largimi eventual masiv i

qytetarëve të Kosovës pas liberalizimit të vizave, përveçse do të ndikojë në aktivitetin ekonomik të bizneseve, do ta ulë edhe konsumin në Kosovë. Të gjitha këto pastaj reflektohen në rritjen ekonomike", thotë Mulaj për "Radio Evropa e Lirë". Kosova prej vitesh përballet me mungesë punëtorësh të profileve të ndryshme. "Radio Evropa e Lirë" ka raportuar disa herë se si bizneset detyrohen të importojnë punëtorë nga jashtë. Me 1.7 milion banorë, Kosova ka një shkallë të papunësisë prej 12-përqindësh. Paga mesatare bruto është 520 euro, ndërsa minimalja sillet nga 130 deri në 170 euro. Të dhënat e Agjencisë së Punësisë të Kosovës flasin për rënie të numrit të punëkërkuarëve ndër vite: nga rreth 300 mijë punëkërkuarë të regjistruar në vitin 2013, numri i tyre ka rënë në rreth 29 mijë në prill të këtij viti. Drejtori i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Prishtinë, Skënder Krasniqi, thotë se në tre vjetët e fundit punëtorët nga

Kosova, me procedura më të lehtësuara, janë pajisur me leje pune dhe kanë ikur në vendet e BE-së.

Gjermania është një prej atyre që i ka lehtësuar procedurat e pajisjes me dokumente të huajve.

Vitin e kaluar numri i vizave të punës të lëshuara nga Ambasada e Gjermanisë në Kosovë është rritur për 110 për qind në krahasim me vitin paraprak.

Krasniqi thotë se këto shifra do të rriten edhe më pas liberalizimit të vizave, edhe pse kjo lëvizje e lirë nuk nënkupton udhëtime për qëllime pune. "Qytetarët do të kenë mundësi të shkojnë për vizitë në vendet e BE-së, por edhe të gjejnë një vend pune dhe më pas të pajisen me vizë pune", thotë ai.

Mungesa e punëtorëve ndikon pastaj në rënie të aktivitetit ekonomik, thotë Krasniqi.

## Gjendja në shifra

Agjencia e Statistikave e Kosovës nuk ka ende të dhëna për vitin 2022 dhe për këtë vit, por ato të vitit 2021 tregojnë se nga Kosova janë larguar mbi 42 mijë banorë për arsye të ndryshme, në mesin e tyre edhe për punësim. Për më tepër, Kosova prej vitesh vuan nga deficit i lartë tregtar, pasi shumicën e produkteve e importon nga vendet fqinje ose ato të BE-së.

Në vitin 2022, sipas të dhënave të ASK-së, Kosova ka eksportuar produkte në vlerë rreth 1 miliard euro, ndërsa ka importuar produkte në vlerë mbi 5 miliardë euro.

Norma mesatare e inflacionit në vitin 2022 ka qenë gati 12 për qind, edhe pse trendi tash është në rënie. Sipas të dhënave të BQK-së, investimet e huaja në Kosovë në vitin 2022 kanë kapur vlerën e mbi 750 milionë eurove - nga mbi 420 milionë euro sa kanë qenë në vitin 2021. Po sipas BQK-së, investimet më të mëdha bëhen në sektorin e patundshmërisë dhe ato vijnë kryesisht nga diaspora e Kosovës.

Kosova, po ashtu, pranon një shumë të madhe remitencash: mbi 1.2 miliard euro vetëm vitin e kaluar.

## ASK-ja: Regjistrimi i ndërmarrjeve publike, rritje prej 4.8 %

**PRISHTINË, 29 TETOR** - Në tremujorin e tretë të vitit 2023, krahasuar me tremujorin paraprak (TM2 2022), kemi rritje për 7.1 % të ndërmarrjeve të regjistruara. Ndërsa krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (TM3 2022), kemi rritje për 4.8 % të ndërmarrjeve të regjistruara. Sa iu përket ndërmarrjeve të

shuara, në TM3 2023, sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave e Kosovës, janë 376 ndërmarrje apo rënie prej -5.5 % krahasuar me tremujorin paraprak (TM2 2023). Ndërsa krahasuar me tremujorin e njëjtë të vitit paraprak (TM3 2022), kemi rritje për 1 % të ndërmarrjeve të shuara. Aktivitetet ekonomike më të

pëlqyera gjatë këtij tremujori ishin: Tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i mjeteve motorike, motoçikletave 617 (21.6 %), aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike 334 (11.7 %), akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim 228 (10.1 %), ndërtimtari 275 (9.6 %), prodhim 272 (9.5 %) etj.



# A po e fiton luftën Hamasi?

## Nga Yuval Noah HARARI

Lufta është vazhdimi i politikës me mjete të tjera. Shumë njerëz e recitojnë këtë mantra, por shumë pak i kushtojnë vëmendje të mjaftueshme – veçanërisht në mes të luftës. Me masakrën e Hamasit në Izrael dhe me numrin e viktimave civile në rritje në Gaza, logjika e thellë e luftës, fshihet nga mjerimi i pamasë njerëzor që prodhon. Ndërsa trupat vazhdojnë të grumbullohen, kush do ta fitojë këtë luftë? Jo pala që vret më shumë njerëz, jo pala që shkatërron më shumë shtëpi dhe as pala që fiton më shumë mbështetje ndërkombëtare – por pala që arrin qëllimet e saj politike.

Hamasi e nisi këtë luftë me një qëllim politik specifik: të parandalonte paqen. Pas firmosjes të traktateve të paqes me Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Bahreinin, Izraeli ishte në prag të firmosjes së një traktati historik paqeje me Arabinë Saudite. Kjo marrëveshje do të ishte arritja më e madhe e kryeministrit Benjamin Netanyahu, në të gjithë karrierën e tij. Do të kishte normalizuar marrëdhëniet midis Izraelit dhe pjesës më të madhe të botës arabe. Me insistimin e sauditëve dhe amerikanëve, kushtet e traktatit pritej të përfshinin lëshime të rëndësishme për palestinezët, që synonin të lehtësonin menjëherë vuajtjet e miliona prej tyre në territoret e pushtuara dhe të rifillonin procesin e paqes izraelito-palestineze.

Perspektiva e paqes dhe normalizimit ishte një kërcënim vdekjeprurës për Hamasin. Që nga themelimi i saj në vitin 1987, kjo organizatë fundamentaliste islamike nuk e njohu kurrë drejtën e Izraelit për të ekzistuar, dhe u angazhua për luftë të armatosur pa kompromis. Në vitet '90, Hamasi bëri gjithçka që mundej për të prishur procesin e paqes në Oslo.

Për më shumë se një dekadë, qeveritë izraelite të udhëhequra nga Netanyahu braktisën të gjitha përpjekjet serioze për të bërë paqe me forcat më të moderuara palestineze, miratuan një politikë të një vije gjithnjë e më të ashpër në lidhje me pushtimin e territorit të diskutuar dhe madje përqafuan idetë mesianike të krahut të djathtë, mbi supremacinë e hebrenjve.

Gjatë asaj periudhe, Hamasi tregoi një përmbajtje befasuese në marrëdhëniet e tij me Izraelin dhe të dy palët dukej se po adoptonin një politikë shqetësuese, por gjithësesi funksionale të bashkëjetesës së dhunshme. Por më 7 tetor, pikërisht kur qeveria e Netanyahu ishte në prag të një përparimi të madh për paqen rajonale, Hamasi goditi me gjithë forcën e tij.

Hamasi vrau qindra civilë

izraelitë, në mënyrat më të tmerrshme që mundej. Qëllimi i menjëhershëm ishte të prishte marrëveshjen e paqes izraelito-saudite. Synimi afatgjatë ishte të mbillte farat e urrejtjes në mendjet e miliona njerëzve në Izrael dhe në mbarë botën myslimane, duke parandaluar kështu paqen me Izraelin, për brezat që do të vijnë.

Hamasi e dinte se sulmi i tij do t'i bënte izraelitët të reagonin me zemërim nga dhimbja, dhe terroristët e dinin se Izraeli do të hakmerrej me forcë masive, duke u shkaktuar dhimbje të madhe palestinezëve. Emri i koduar që Hamasi i dha operacionit të tij flet shumë: al-Aqsa Tufan. Fjala "tufan" do të thotë përmbytje. Ashtu si përmbytja biblike që synonte të pastronte botën nga mëkati, edhe me koston e gatishmërisë së zhdukjes së njerëzimit, sulmi i Hamasit synonte të krijonte shkatërrim në një shkallë biblike.

A nuk i bëhet vonë Hamasit, për vuajtjet që kjo luftë u shkakton civilëve palestinezë? Ndërsa aktivistët e Hamasit, individualisht, me siguri kanë ndjenja dhe qëndrime të ndryshme, botëkuptimi i organizatës e tkurr mjerimin e individëve. Qëllimet politike të Hamasit diktohen nga fantazitë fetare.

Ndryshe nga ato të lëvizjeve laike si Organizata për Çlirimin e Palestinës, qëllimet përfundimtare të Hamasit nuk janë të kësaj bote. Për Hamasin, palestinezët e vrarë nga Izraeli janë martirë që gëzojnë lumturinë e përjetshme në parajsë. Sa më shumë të vrarë, aq më shumë dëshmorë.

Sa i përket kësaj bote, sipas pikëpamjeve të Hamasit dhe grupeve të tjera fundamentaliste myslimane, i vetmi objektiv i zbatueshëm për një shoqëri njerëzore në Tokë është respektimi i pakushtëzuar i standardeve qiellore të pastërtisë dhe drejtësisë. Për shkak se paqja përfshin gjithmonë kompromis mbi atë që njerëzit e konsiderojnë drejtësi, ajo duhet të refuzohet dhe drejtësia absolute duhet të ndiqet me çdo kusht.

Kjo, meqë ra fjala, shpjegon një fenomen të çuditshëm të kohëve të fundit në mesin e së majtës radikale në shumë demokraci perëndimore, duke përfshirë disa organizata studentore në Universitetin e Harvardit. Ata e çlirojnë Hamasin nga çdo përgjegjësi për mizoritë e kryera në Be'eri, Kfar Azza dhe fshatra të tjerë izraelitë, apo për krizën humanitare në Gaza.

Këto organizata ia vënë 100 për qind fajin Izraelit.

Lidhja midis të majtës radikale dhe organizatave fundamentaliste si Hamasi është besimi në drejtësinë absolute, e cila çon në një refuzim për të pranuar kompleksitetin e realiteteve në këtë botë. Drejtësia është një kauzë fisnike, por kërkesa për drejtësi absolute çon në mënyrë të pashmangshme në



luftë të pafundme. Në historinë e botës, nuk është arritur asnjë traktat paqeje që nuk ka kërkuar kompromis, apo që ka siguruar drejtësi absolute.

Nëse qëllimet e luftës së Hamasit janë me të vërtetë të prishin traktatin e paqes izraelito-saudite dhe të shkatërrojnë të gjitha mundësitë për normalizim dhe paqe, ai po e fiton këtë luftë me nokout. Dhe Izraeli po e ndihmon Hamasin, kryesisht sepse qeveria e Netanyahu duket që po e zhvillon këtë luftë pa qëllime të qarta politike.

Izraeli thotë se dëshiron të çarmatosë Hamasin dhe ka çdo të drejtë ta bëjë këtë për të mbrojtur qytetarët e tij. Çarmatosja e Hamasit është gjithashtu jetike për çdo shans për paqe në të ardhmen, sepse për sa kohë Hamasi mbetet i armatosur, ai do të vazhdojë të prishë çdo përpjekje. Por edhe nëse Izraeli arrin të çarmatosë Hamasin, kjo është vetëm një arritje ushtarake, jo politike. Në planin afat shkurtër, a ka Izraeli ndonjë plan për të shpëtuar marrëveshjen e paqes izraelito-saudite? Në planin afatgjatë, a ka Izraeli ndonjë plan për të arritur një paqe gjithëpërfshirëse me palestinezët dhe për të normalizuar marrëdhëniet me botën arabe?

Duke qenë thellësisht i përfshirë në politikën izraelite gjatë vitit të kaluar, kam frikë se të paktën disa anëtarë të qeverisë aktuale të Netanyahu janë edhe vetë të fiksuar tek vizionet biblike dhe drejtësinë absolute, dhe kanë pak interes për kompromisin që sjell paqe.

Të gjitha palët e interesuara duhet të mos lejojnë që përmbytjen e lëshuar nga Hamasi të mbyset Izraelin dhe palestinezët, si dhe të shkatërrojë rajonin. Vini re se lufta bërthamore është, teorikisht, ndoshta vetëm 24 orë larg – nëse Hezbollahu dhe aleatët e tjerë iranianë godasin Izraelin me dhjetëra mijëra raketa, siç po kërcënojnë të bëjnë, Izraeli mund të përdorë armët bërthamore për vetë-mbrojtje. Prandaj, të gjitha palët duhet të

braktisin fantazitë biblike dhe kërkesat për drejtësi absolute dhe të përqendrohen në hapa konkretë për të shmangur konfliktin dhe mbjellë farën për paqen dhe pajtimin.

Pas ngjarjeve të dy javëve të fundit, pajtimi duket krejtësisht i pamundur. Familja dhe miqtë e mi sapo kanë parë nëpër skena që të kujtojnë tmerret e Holokaustit. Por tetë dekada pas Holokaustit, gjermanët dhe izraelitët janë miq të mirë. Hebrenjtë nuk morën kurrë drejtësi absolute për Holokaustin – si mundej? A mundet ndokush t'u kthejë viktimave britmat e dhimbjes në fyt, ta kthejë mbrapsht tymin në oxhaqet e Aushvicit dhe t'i kthejë të vdekurit nga krematoriumet? Si historian, e di mirë që mallkimi i historisë është se ajo frymëzon dëshirën për të rregulluar të kaluarën. Kjo është përpjekje e pashpresë.

E kaluara nuk mund të shpëtohet. Përqendrohuni në të ardhmen. Lërimi plagët e vjetra të shërohen në vend që të shërbejnë si shkak për lëndime të reja.

Në vitin 1948, qindra-mijëra palestinezë humbën shtëpitë e tyre në Palestinë. Si hakmarrje, në fund të viteve 1940 dhe në fillim të viteve 1950, qindra-mijëra hebrenj u dëbuan nga Iraku, Jemeni dhe vendet e tjera myslimane. Që atëherë, plagët janë grumbulluar mbi plagë, në një rreth vicioz dhune që ka çuar vetëm në më shumë dhunë. Ne nuk jemi të detyruar ta përsërisim këtë cikël përgjithmonë. Natyrisht, në mesin e kësaj lufte të tmerrshme, ne nuk mund të shpresojmë të ndalojmë ciklin njëherë e përgjithmonë. Ajo që na duhet tani është të parandalojmë përshkallëzimin e mëtejshëm dhe për këtë kërkojmë disa gjeje konkrete shprese.

Një iniciativë e propozuar kërkon që Hamasi të lirojë të gjitha gratë, fëmijët dhe foshnjat që mban peng, në këmbim të lirit nga Izraeli të disa dhjetëra grave dhe adoleshentëve palestinezë që mbahen të burgosur. A do të ishte kjo drejtësi? Jo. Drejtësia kërkon që Hamasi të lirojë menjëherë

dhe pa kushte të gjithë pengjet që mori. Por kjo nismë mund të jetë gjithësesi një hap drejt uljes së konfliktit.

Një nismë tjetër është që t'u mundësohet civilëve palestinezë të largohen nga Rripi i Gazës për siguri në vende të tjera. Egjipti, që ndan një kufi me Gazën, mund dhe duhet të marrë drejtimin për këtë. Por nëse Egjipti nuk arrin të ofrojë ndihmë, Izraeli mund të sigurojë strehë për civilët e zhvendosur të Gazës, në tokë izraelite.

Nëse asnjë vend tjetër nuk është i gatshëm të pranojë dhe mbrojë civilët palestinezë, atëherë pasi Kryqi i Kuq të ketë qasje te pengjet izraelite të mbajtur nga Hamasi dhe të ketë konstatuar gjendjen e tyre, Izraeli mund të ftojë Kryqin e Kuq dhe grupet e tjera humanitare ndërkombëtare që të krijojnë strehë të përkohshme për civilët e zhvendosur të Gazës në anën izraelite të kufirit. Këtu do të strehoheshin gra, fëmijë dhe të evakuuar nga spitalet e Rripit të Gazës, ndërsa lufta kundër Hamasit vazhdon, dhe në fund të luftimeve, Gazanët e zhvendosur do të ktheheshin në Rripin e Gazës.

Hedhja e një hapi të tillë do të përmbushte detyrën morale të Izraelit për të mbrojtur jetët e civilëve palestinezë dhe njëkohësisht do të ndihmonte Forcat Mbrojtëse të Izraelit të vazhdonin luftën kundër terroristëve të Hamasit, duke reduktuar numrin e civilëve të ngecur në zonën e luftimit.

A kanë mundësi të realizohen nisma të tilla? Nuk e di. Por e di që lufta është vazhdimi i politikës me mjete të tjera, se qëllimi politik i Hamasit është të shkatërrojë çdo shans për paqe dhe normalizim, dhe se qëllimi i Izraelit duhet të jetë ruajtja e mundësisë për paqe. Ne duhet ta fitojmë këtë luftë, në vend që të ndihmojmë Hamasin të arrijë qëllimin e vet.

Yuval Noah Harari është autori i "Sapiens", "Homo deus" dhe "Unstoppable us" dhe profesor i historisë në Universitetin hebraik të Jeruzalemit. / Në shqip nga bota.al



# SHBA e ka harruar rolin që duhet të luajë në Lindjen e Mesme



**Fareed ZAKARIA**

Kriza në Lindjen e Mesme ka zbuluar një realitet të rëndësishëm për botën. Megjithatë ndikimi amerikan mund të mos jetë ai që ishte dikur, është sërish e vërtetë se asnjë vend tjetër nuk mund të zëvendësojë Shtetet e Bashkuara, si lojtar kryesor në skenën globale. Por për të ruajtur këtë ndikim, SHBA do të duhet të veprojë me mençuri dhe të shkojë më tej se sa ka bërë deri tani.

Mendoni se sa të munguara kanë qenë Rusia dhe Kina në këtë krizë. Gjatë viteve të fundit, të dyja fuqitë janë përpjekur në mënyra të ndryshme të injektohen në rajon. Rusia ndërtoi lidhjet e veta me Izraelin. Kina ndihmoi në lehtësimin e rivendosjes së lidhjeve diplomatike midis Arabisë Saudite dhe Iranit. E megjithatë, që kur shpërtheu kriza e Gazës, asnjëra nuk ka qenë në gjendje të luajë ndonjë rol në zbutjen e tensioneve, apo në ofrimin e zgjidhjeve.

Ndërkohë, Shtetet e Bashkuara kanë qenë të angazhuara aktivisht që nga fillimi. Urdhëri i parë i Presidentit Biden ishte të dënonte sulmet terroriste të Hamasit dhe të qëndronte në

solidaritet me Izraelin. Duke e bërë këtë me elokucencë, ai tani është zhvendosur në pozicionin e dhënies së këshillave për maturi. Ai u bëri thirrje izraelitëve që të mos konsumohen nga zemërimi dhe u kujtoi atyre reagimin e Shteteve të Bashkuara ndaj 11 shtatorit, duke pranuar se Uashingtoni, i konsumuar nga frika dhe zemërimi, bëri gabime.

Shpresohet se Izraeli po dëgjon. Presidenti ka të drejtë: Shtetet e Bashkuara morën një sërë vendimesh katastrofike pas 11 shtatorit, për të cilat ende po paguajnë një çmim. SHBA nxitoi të ndërtonte një burokraci të re për "sigurinë e atdheut" që përfshin qindra mijëra njerëz dhe dy duzina organizatash.

Zgjerimi dramatikisht pushtetin ekzekutiv, duke shkelur të drejtat individuale, duke zgjeruar sekretin qeveritar dhe duke sanksionuar atë që shumë do ta përshkruanin si torturë.

Strategjia ushtarake e Uashingtonit ishte gjithashtu e metë, që në krye të herës. Në vend që të fokusohet ngushtësisht te njerëzit që planifikuan dhe ekzekutuan 11 shtatorin, SHBA miratoi një qasje të gjerë dhe ambicioze që, sipas fjalëve të Presidentit

George W. Bush, nuk bënte "asnjë dallim" midis terroristëve dhe "atyre që i strehojnë ata". Kështu, vendi shkoi në luftë jo vetëm kundër al-Kaedës, por edhe kundër talebanëve, duke u përpjekur të garantonte që këta të fundit të mos sundonin më kurrë Afganistanin, një objektiv që përfshinte një luftë 20-vjeçare, të cilën Shtetet e Bashkuara e humbën. Dhe, sigurisht, shkoi më pas në luftë kundër Saddam Huseinit në Irak. Përgjigja e Uashingtonit ndaj 11 shtatorit – luftërat, burokracia etj – ka pasur një çmim, sipas një vlerësimi, prej 8 trilion dollarësh.

Mësimet për Izraelin janë të qarta. Një pushtim tokësor në Gaza është një përgjigje emocionale ndaj sulmit terrorist të Hamasit. Izraeli po përgjigjet me diçka të madhe dhe të guximshme, duke demonstruar se mund të shkojë përtej një qasjeje të vogël dhe të bëjë diçka dramatike. Por a është e mençur kjo? Një kurs i tillë do ta zhytë ushtrinë izraelite në rrugicat dhe tunelet e Gazës. Me siguri do të prodhohë edhe më shumë tragjedi humanitare në Gaza, duke zemëruar më tej vendet arabe dhe duke e kthyer opinionin botëror kundër Izraelit. Edhe nëse pas gjithë kësaj fiton, çfarë do të ketë

fituar? Kush do ta qeverisë Gazën pas Hamasit? Kush do të jetë i gatshëm të pushtojë Rripin dhe të luftojë atë që sigurisht do të jetë një kryengritje kundër autoritetit të tij? Asnjë vend arab apo evropian nuk do ta merrte përsipër, kështu që do t'i bjerë Izraelit. Kishte një arsye pse një nga ushtarët më të dekoruar të Izraelit dhe figurat më të djathta politike, Ariel Sharon, zgjodhi të largohej nga Gaza.

Qëllimi i terrorizmit është të provokojë një reagim të tepruar. Përgjigja më e mirë ndaj tij është të mos humbasësh mendjen. Në të kaluarën, Izraeli u është përgjigjur shpesh sulmeve terroriste duke marrë kohën e vet, duke gjurmuar ata që në të vërtetë planifikonin dhe ekzekutonin misionet, dhe më pas duke i vrarë. Kjo ishte përgjigja e tij ndaj masakrës së Lojërave Olimpikë të Mynihut të vitit 1972, ekzekutuar nga grupi palestinez "Shtatori i Zi". Nëse Uashingtoni do t'i ishte afuar Al-Kaedës me një qasje të ngjashme strategjike, Shtetet e Bashkuara do të ishin në një pozitë shumë më të mirë sot. Përveç këshillës së tij për maturi, Biden duhet të bëjë presion ndaj qeverisë izraelite që të sigurojë një rrugë politike për aspiratat palestineze. Për disa dekada, Shtetet e

Bashkuara – nën administratën republikane dhe demokratike – shiheshin si një ndërmjetës efektiv midis dy palëve. Zyrtarët palestinezë u besuan diplomatëve amerikanë si Martin Indyk, Dennis Ross dhe Edward Djerejian, sepse ata punuan pa u lodhur për të gjetur një rrugë të negociuar për një shtet palestinez. Shtetet e Bashkuara i bënë presion OÇL-së që të hiqte dorë nga terrorizmi dhe të njëjtte Izraelin, por njëkohësisht u bëri presion izraelitëve që të ndalonin ndërtimin e vendbanimeve.

Të gjitha këto përpjekje janë dobësuar pasi udhëheqja palestineze u tregua e pamend dhe Izraeli është qeverisur nga një sërë qeverish të krahut të djathtë që nuk besojnë në një zgjidhje me dy shtete, kanë shtuar vendbanimet dhe kanë mbyllur një sy ndaj gjendjes së palestinezëve. Këto janë kushte ideale për Hamasin, i cili argumenton se nuk ka zgjidhje jo të dhunshme, dhe se aktet e terrorizmit janë opsioni i vetëm. Është një përpjekje madhore për diplomacinë amerikane. Por alternativa është që kjo krizë të acarohet, dhe tani ajo mund të rezultojë kollaj në një dhunë, që do të jetë edhe më e keqe se sa ajo që po shohim tani. / The Washington Post – Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Invert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Fitore bindëse për Trepçën e Rahovecin

**MITROVICË, 29 TETOR** - Dy kryendeshjet e xhiros së tetë të Superligës së Kosovës në hendboll (meshkujt) nuk kanë ofruar rivalitetin për të cilin shpresohet. Trepça e Rahoveci kanë shënuar fitore bindëse për të vazhduar ecurinë pozitive në kampionat. Në palestrën

“Minatori” në Mitrovicë, Trepça e mposhti Kastriotin me rezultat 40:30. Që në pjesën e parë “xehetarët” bënë shkëputje në rezultat, e cila në pjesën e dytë ishte edhe më e madhe. Sali Maxhera, Hamdi Salihu dhe Lulzim Shabani i shënuan nga tetë gola për mitrovicasit,

sa i kishte edhe Festim Mustafa i Kastriotit. Në Ferizaj, në hapje të kampionatit, Kastrioti kishte fituar me një gol dallim. Më pas Trepça rreshtoi pesë fitore. Renditet e dyta. Kastrioti i ka tri fitore e katër humbje. Me gjashtë pikë renditet i pesti. Në tabelë

udhëheq Rahoveci me dhjetë pikë. “Vreshtarët” i kanë fituar të gjitha pesë ndeshjet e deritashme. Të dielën fituan ndaj Prishtinës me rezultat bindës, 47:31. Adonit Isufi i shënoi 13 gola për Rahovecin. Nëntë gola për Prishtinën i shënoi Albi Gjuka. Prishtina është e



katërta me tetë pikë. Ka katër fitore e tri humbje.

## Ballkani dominon në Superligë, gabojnë Drita dhe Llapi

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 29 TETOR** - Kampionia në fuqi e Superligës në futboll, Ballkani e ka vazhduar dominimin në elitë, pasi ka shënuar fitore të dielën si mysafirë kundër Feronikelit 74, në stadiumin “Rexhep Rexhepi” në Drenas, me rezultat bindës 3-0. Vendasit u mbajtën deri në fund të pjesës së parë kur Almir Kryeziu realizoi për 0-1. Në minutën e 66-të, Edvin Kuç realizoi golin e dytë për Ballkanin, derisa Nazmi Gripshi gjashtë minuta para fundit e vlosi rezultatit final 0-3. Ballkani me tri pikët e reja përforcohet në pozitën e parë me 26 pikë, katër më shumë se ndjekësja më e afërt Drita, e cila

barazoi të dielën me Lirinë me rezultat 1-1. Drita kaloi në epërsi pas tre minutave lojë me golin e Besnik Krasniqit, derisa një pikë prizrenasve ia siguroi Prins Tijueza (73’). Ndërsa baras është mbyllur ndeshja mes Dukagjinit dhe Llapi (0-0), e cila u zhvillua në stadiumin “18 Qershori”. Dukagjini renditet në pozitën e gjashtë me 13 pikë, kurse Llapi është në vendin e tretë me 20 pikë. Të shtunën skuadra e Prishtinës ka shënuar fitoren e parë nën drejtimin e trajnerit të ri Emmanuel Egbo. Pas shtatë ndeshjeve pa fitore, kryeqytetasit iu gëzuan fitores në stadiumin “Fadil Vokrri” në përballje me Gjilanin (2-1). Golat për Prishtinën i realizoi sulmuesi amerikan, Jalen Blesa (42’



e 95’). Ndërkaq, golin e barazimit të përkohshëm për skuadrën e drejtuar nga Gentjan Mezzani e realizoi Redon Ismaili (80’). Prishtina është në vendin e katër

me 16 pikë, kurse Gjilani në vendin është me 11 pikë. Ndërsa ndeshja tjetër mes Fushë Kosovës dhe Malishevës përfundoi me rezultat 0-0.

SUPERLIGA		
Feronikeli 74 - Ballkani		0-3
Dukagjini - Llapi		0-0
Drita - Liria		1-1
Fushë Kosova - Malisheva		0-0
Prishtina - Gjilani		2-1
Tabela		
	Pikë	Pikë
1. Ballkani	10	26
2. Drita	10	22
3. Llapi	11	20
4. Prishtina	11	16
5. Malisheva	11	13
6. Dukagjini	11	13
7. Gjilani	11	11
8. Feronikeli	11	11
9. Liria	11	7
10. Fushë Kosova	11	6

## Trepça triumfon ndaj Bashkimit, Vëllaznimi regjistron fitoren e dytë radhazi

“Epoka e re”

**PRIZREN, 29 TETOR** - Trepça ka shënuar fitore në Prizren ndaj Bashkimit me rezultat 77:99 (18:33, 19:23, 23:20, 17:23), në javën e gjashtë të Prince Caffë Superligës. Mysafirët e nisën ndeshjen më mirë, me një seri prej 4:14 dhe gjatë gjithë çerekut të parë ishin në epërsi, duke e ngritur atë në 15 pikë, 18:33, sa përfundoi kjo pjesë. “Xehetarët” vazhduan me lojë të mirë dhe shtoi epërsinë në 23 pikë, 26:49, kurse pjesa e parë përfundoi 37:56. Prizrenasit u munduan të rikthehen në periudhën e tretë për të afruar rezultatit në 60:70, sidoqoftë, Galloway me dy treshe radhazi ngrit epërsinë në 60:76, sa



ishite rezultati pas 30 minutash. Në dhjetë minutat e fundit nuk kishte

ndonjë ndryshim të madh me Trepçën që ruajti epërsinë, madje e

shtoi për të triumfuar 77:99. Te Bashkimi më i miri ishte Grant Lozoya me 21 pikë, ndërsa te Trepça më të mirët ishin Drilon Hajrizi me 20 pikë e nëntë kërcime dhe Isaiah Ross e debutuesi Brevin Galloway me nga 20 pikë. Bashkimi ka tri fitore e tri humbje, kurse Trepça pesë fitore e një humbje. Ndërsa Vëllaznimi regjistroi fitoren e dytë radhazi. Kësaj radhe skuadra nga Gjakova mposhti Istogun në Pejë me rezultat 65:102 (18:33, 18:20, 11:22, 18:27). Sfidu u zhvillua në kuadër të javës së gjashtë të Prince Caffë Superligës. Kuqezinjtë e nisën ndeshjen më mirë dhe për një nuancë ishin më të mirë në çerekun e parë, por me kalimin e minutave e thelluan epërsinë, që

shkoi deri në 15 pikë, 15:30 dhe 18:33, sa përfundoi kjo pjesë. Periudha e dytë ishte më e barabartë, ndërsa mysafirët shkuan në pushim me rezultat 36:53. Edhe në periodën e tretë, skuadra nga Gjakova ishte bindshëm më e mirë 11:22, ndërsa me lojë të mirë vazhduan edhe në dhjetë minutat e fundit për të triumfuar 65:102. Më të dalluarit te istogasit ishin Tyrese Prince me 16 pikë e shtatë kërcime dhe Mirlind Zekaj me 14 pikë e pesë kërcime, ndërsa më të mirët te Vëllaznimi ishin Jordan Dallas me 21 pikë e 11 kërcime dhe Samuel Sessoms me 25 pikë e pesë kërcime. Istogu ka një fitore e pesë humbje, kurse Vëllaznimi dy fitore e katër humbje.

## Prishtina 01 kualifikohet në ‘Elite Round’ në Ligën e Kampionëve

**PRISHTINË, 29 TETOR** - Kampioni në fuqi i Kosovës në futsall, FC Prishtina 01 ka arritur sukses historik, duke u kualifikuar në “Elite Round” në Ligën e Kampionëve. Prishtina 01, të shtunën në Kaunas të Lituanisë, e mposhti AEL-in e Qipros, me

rezultat 8:2. Megjithatë, kualifikimi i kryeqytetasve varej edhe nga rezultati i ndeshjes tjetër të grupit ndërmjet Kauno Zhalgirisit dhe Kampuksen Dynamos, e cila u mbyll me rezultat 1:1 dhe kësajsoj kampioni i Kosovës e konfirmoi

pjesëmarrjen në fazën e grupeve, duke qenë në mesin e 16 skuadrave më të mira të Evropës. Kësajsoj, Prishtina 01 bëhet skuadra e dytë kosovare që e arrin në këtë nivel të garave, ngase vite më parë pjesë e kësaj faze ishte edhe skuadra nga Drenasi,

Feniks. Drilon Maxharraj, Lushi Qerimi, Ylli Mzreku, Arif Limani e Halim Selmanaj me dy gola dhe Ermir Kryeziu me një gol kontribuan në fitoren tejet të rëndësishme të Prishtinës 01 ndaj AEL-it. Shorti për “Elite Round” do të tërhiqet më 2



nëntor, derisa faza e grupeve zhvillohet prej 28 nëntorit deri më 3 dhjetor.

## Veliaj: Tirana, ka pritur 1 mijë ngjarje sportive këtë vit

TIRANË, 29 TETOR - Në vitin e Qytetit Evropian të Sportit, Tirana po gëlon nga aktivitetet sportive. Kryeqyteti shqiptar mirëpriti për herë të parë Kampionatin Botëror të Mundjes për të rinjtë deri në 23 vjeç, ku morën pjesë mbi 1100 mundës dhe trajnerë nga 60 vende të botës. I pranishëm në ceremoninë e ndarjes së

çmimeve, kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, tha se në vitin e Qytetit Evropian të Sportit, kryeqyteti ka pritur më shumë se një mijë aktivitete sportive. "Faleminderit që e keni kthyer Tiranën, edhe kësaj here, në një super arenë sportive. Këto tapete nuk janë vetëm tapete për dyluftim, janë kryesisht tapete për miqësi. Sigurisht, në

ato 5 minuta dyluftojmë, por ama për 50 vitet e ardhshme kemi krijuar miqësi mes sportistëve, skuadrave dhe shteteve. Ndaj, sot në një botë që po gëlon me konflikte nga më të ndryshmet, është shumë e rëndësishme që sporti të jetë një instrument që na bashkon, që na afron", ka thënë Veliaj. "Këtë vit Tirana ka pasur rreth 1000

aktivitete dhe ky kampionat botëror i të rinjve nën moshën 23 vjeç është vetëm një prej tyre. Do të vazhdojmë me aktivitetet deri në fund të vitit, duke e kthyer Tiranën në një kryeqytet të Evropës për sportin këtë vit. Ne duam ta vazhdojmë çdo vit këtë, duke mbështetur Federatën, edhe kampionët tanë, por sidomos sportin në



komunitet, duke hapur të gjitha palestrat dhe duke u siguruar që çunat dhe gocat tanë mësojnë nga më të mirët e botës", ka shtuar Veliaj.

## Qerimi: Ambiciet janë ta kalojmë Sllovakinë

PRISHTINË, 29 TETOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në hendboll, Bujar Qerimi, ka folur në prag të grumbullimit të Përfaqësueses për ndeshjet me Sllovakinë. Ndeshja e parë me Sllovakinë është të enjten prej orës 18:00 në Povazska Bystrica. Ndërsa ndeshja e dytë është më 5 nëntor në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në Prishtinë. Ndeshjet i takojnë fazës së parë të kualifikimeve evropiane për Kampionatin Botëror të vitit 2025. Përfaqësuesja më e mirë pas dy ndeshjeve avancoi tutje. Grumbullimi i Përfaqësueses është bërë të dielën mërzë, ndërsa Qerimi do të mbajë të hënën dy stërvitje me të përzgjedhurit e tij. Të martën është udhëtimi për në Sllovaki, ku planifikohen edhe disa stërvitje. "Situata është pak e komplikuar. Kemi disa mungesa të lojtarëve kryesorë. Vëllezërit



Tahirukaj nuk vinë në grumbullim. Bujar Ramosaj ka probleme në vend të punës, ndërsa për Valon Dedajn jemi në pritje të përgjigjes të hënën. Lojtarët e tjerë do të jenë prezentë. Ambiciet janë ta kalojmë me sukses këtë

përballje të dyfishtë me Sllovakinë. Sa i përket kualitetit, Sllovakia është e përafërt me Përfaqësuesen tonë. Por me mungesat që kemi ndryshon pak situata. Ne natyrisht e kemi për detyrë të japim maksimumin", ka thënë Qerimi.

## Fury vazhdon të jetë i pamposhtur

RIYADH, 29 TETOR - Boksieri britanik Tyson Fury fitoi me vendim shumicë duelin e "njeriut më të keq në planet" ndaj kamerunasit Francis Ngannou. Sfida e zhvilluar në Arabinë Saudite ishte mjaft e bukur, e ekuilibruar në të 10 raundet, ku të dy boksierët mund ta fitonin atë. Dy nga gjyqtarët i dhanë fitoren Fury (96-93 dhe 95-94), ndërsa një gjyqtar i dha fitoren Ngannou (95-94). Kamerunasi, që debutonte në ring sonte, shpeshoi te fitorja, sidomos pasi hodhi Fury në tapet në raundin e tretë, por nuk ia doli dot mbanë. Nga ana tjetër, Fury u duk sikur donte të kontrollonte rivalin në distancë, duke fituar shumicën e raundeve, por pa dhënë atë që pritej. Mungoi sulmi i fortë dhe agresiv i britanikut, që më së shumti ruajti energjitë edhe pse nuk e kishte të sigurt fitoren. Ngannou synonte fitoren, por edhe me këtë rezultat mbeti i



kënaqur, pasi donte t'i tregonte botës se di të boksojë. Ish-kampioni i botës në peshën e rëndë në artet marciale mikse konfirmoi se mund të jetë një pretendent në këtë sport. Tyson Fury mbeti i pamposhtur (ka rekordin 34 fitore e 1 barazim në karrierë), por duket se mendjen e kishte te sfida me Usyk, i pranishëm në stadium. Të

shumtë personazhet VIP në stadium që ndoqën "live" duelin dhe u argëtuan. Dueli nisi i avashtë nga të dy boksierët, që duket se fillimisht studiuuan njëri-tjetrin e më pas u bënë më agresivë. Ngannou tregoi grintë dhe rezistoi deri në fund, ndërkohë që Fury fitoi pa shumë shkëlqim, duke treguar se në ring nuk mundet dot kollaj.

### SHKURT

#### Kosova fiton medaljen e bronzë në Kampionatin Botëror të karatesë

Përfaqësuesja e Kosovës në karate në konkurrencën e femrave ka arritur një sukses të madh. Karateistet e Kosovës kanë zënë vendin e tretë në kampionatin Botëror, duke fituar medaljen e bronzë. Në botërorin e zhvilluar në Budapest të Hungarisë, Kosova fitoi 2:0 ndaj Kazakistanit në repesazh. Kosova në grupe mposhti Anglinë, por humbën nga Japonia. Për këtë arsye Japonia e fitoi grupin, duke e dërguar Kosovën në repesazh, ku mposhtën Zvicrën dhe Francën. Është ky prej sukseseve më të mëdha të karatesë kosovare deri më tani.

#### City mund me lehtësi në derbi Unitedin

Manchester City konfirmohet mbret në qytetin e tij, duke mundur rivalët e qytetit në shifrat 3-0. Derbi i shumëpritur u dominua nga skuadra e Guardiola, që tregoi forcën e saj. Erling Haaland ishte heroi i skuadrës së Pep Guardiola me dy gola dhe një asistim për festën e Phil Foden, i cili vulosi suksesin e "qytetarëve". City ndan vendin e dytë me Arsenalin me nga 24 pikë. Dy më pak se Tottenhami kryesues. Skuadra e Erik ten Hag regjistroi humbjen e pestë në dhjetë javët e para në Premier Ligë dhe mban vendin e 8-të me 15 pikë.

#### Duranti rikthen Phoenixin te fitorja në NBA

Phoenix Suns janë rikthyer te fitorja në NBA pas humbje dy ditë më parë nga LA Lakers. Të udhëhequr nga Kevin Durant, Suns para adhuruesve të vet kanë mposhtur Utah Jazz me 22 pikë diferencë 126:104. Kevin Durant ka qenë fantastik në këtë duel me 26 pikë, katër kërcime e shtatë asistime duke i dhënë fitoren Phoenixit. Me lojë të mirë është paraqitur edhe Eric Gordon që shtoi 21 pikë të tjera e katër asistime. Te skuadra mysafire më efikas ishte finlandezi Lauri Markkanen me 19 pikë, por që nuk mjaftuan për fitore.

#### Xavi: Nuk e meritoni humbjen

Barcelona nuk e meritoi humbjen ndaj Real Madridit, sipas trajnerit Xavi Hernandez. Duke folur për "DAZN", trajneri i katalanasve pohoi se ekipi i tij dominoi 60 minutat e para të ndeshjes, por kur nuk shënon për të shkuar në 2-0, futbolli i ka këto gjëra. "Na duhen pesë ose gjashtë raste për të shënuar një gol dhe ata shënojnë dy ose tre gola me dy ose dy raste e gjysmë", ka thënë Xavi. "Sinqerisht, mendoj se ne ishim superiorë. Por Madridin, nëse e fal, i ka këto gjëra për të fituar ndeshjen. Në dhomën e zhveshjes lojtarët flasin për një penallti të pa dhënë, por sot ne nuk humbëm për shkak të arbitrit, sepse nuk i konkretizua rastet, edhe pse morëm një humbje të pamërituar", ka shtuar Xavi. Sa i përket debatit që pati me Vinicius, Xavi e minimizon situatën. Trajneri sqaroi se ai i kishte thënë brazilianit vetëm se ai nuk ishte dakord me një faull ku ai thirrri arbitri, por e bëri këtë "me respekt" si gjithmonë. "E admiroj dhe e respektoj si futbollist", deklaroi Xavi.

## Modriqi: Bellinghami është i jashtëzakonshëm

Luka Modriqi ka thurur lavde për Jude Bellinghamin, i cili realizoi dy gola për Real Madridin ndaj Barcelonës në

pasditen e së shtunës. Modriqi theksoi se Bellinghami është përshtatur shumë shpejt në

"Santiago Bernabeu". "Po më duket që Jude Bellingham ka qenë këtë për një kohë të gjatë, jo vetëm për tre muaj.

Ne jemi të gjithë të lumtur me të. Nuk është rastësi që ai është adaptuar aq mirë. Ai është një djalë i mirë, ka një

talent të madh dhe është duke e shfaqur çdo ditë. Urime për të", ka thënë Modriqi.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

**Kuvendi i Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 15 (2) të Ligjit nr. 08/L-133 për Komisionerin Parlamentar për Forcën e Sigurisë shpall:**

## KONKURS

**Për zgjedhjen e Komisionerit Parlamentar për Forcën e Sigurisë**

### Funksioni i Komisionerit:

Komisioneri Parlamentar për Forcën e Sigurisë së Kosovës ka për mision fuqizimin e kontrollit parlamentar, sundimit të ligjit, dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut për personelin ushtarak në Forcën e Sigurisë së Kosovës. Komisionari zgjidhet me votim të fshehtë nga Kuvendi i Kosovës, me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit të pranishëm dhe që votojnë dhe mandati i tij zgjatë pesë (5) vite pa të drejtë rizgjedhje.

### Kriteret e përzgjedhjes:

1. Kandidatët që aplikojnë për pozitën e Komisionerit duhet ti plotësojnë kriteret si në vijim:

- 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- 1.2. Të kenë diplomë universitare;
- 1.3. Të kenë, së paku, tetë (8) vite përvojë pune profesionale, nga të cilat, së paku pesë (5) vite përvojë në pozita udhëheqës;
- 1.4. Të mos kenë qenë të dënuar me vendim të formës së prerë për vepër penale;
- 1.5. Të kenë integritet të lartë moral dhe profesional;
- 1.6. Të mos jenë larguar nga puna me masë disiplinore;

2. Kandidatët që konkurrojnë për Komisioner të FSK-së i nënshtrohen procesit të verifikimit të kontrollit të sigurisë para fazës së dërgimit në kuvend për votim.

3. Kandidatët të cilët nuk pranojnë të bëhet procesi i verifikimit të kontrollit të sigurisë përjashtohen nga konkurrimi.

### Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale; (diplomat nga universitetet jashtë vendit, duhet të jenë të nostrifikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë);
- Letra motivuese;
- Biografi (CV);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës (duke bashkëngjitur edhe raportin nga Trusti pensional);
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale me vendim gjyqësor të formës së prerë.

## PROCEDURA E KONKURRIMIT

**Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 13 nëntor 2023, në orën 16:00.**

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën: Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Zyra N-217).

### Aplikacionet mund të merren në këto vende:

*Forma e shtypur:* në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose  
*Forma elektronike:* faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara. Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonësë, konsiderohet i pavlefshëm.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
Kuvendi - Skupština - Assembly

**Shodno çlani 15(2) Zakona br. 08/L-133 o parlamentarnom povereniku za bezbednosne snage Skupština Republike Kosovo, raspisuje:**

## KONKURS

**Za izbor parlamentarnog poverenika za Snage bezbednosti**

### Funkcija Poverenika:

Parlamentarni poverenik za Kosovske bezbednosne snage ima za misiju jačanje parlamentarne kontrole, vladavine prava i zaštitu ljudskih prava i sloboda vojnog osoblja u Kosovskim bezbednosnim snagama. Poverenika bira tajnim glasanjem Skupština Kosova, većinom glasova prisutnih i koji glasaju poslanika Skupštine, a njegov mandat traje pet (5.) godina bez prava ponovnog izbora.

### Kriterijumi za izbor:

1. Kandidati koji konkurišu za funkciju Poverenika moraju ispunjavati sledeće kriterijume:

- 1.1. Da su državljanin Republike Kosovo;
- 1.2. Da imaju fakultetsku diplomu;
- 1.3. Da imaju najmanje osam (8.) godina profesionalnog radnog iskustva, od kojih najmanje pet (5.) godina iskustva na rukovodećim pozicijama;
- 1.4. Da nisu pravosnažno osuđivani za krivično delo;
- 1.5. Da imaju visok moralni i profesionalni integritet;
- 1.6. Da nisu otpušteni sa rada uz disciplinsku meru;

2. Kandidati koji konkurišu za komesara KBS-a podležu procesu verifikacije bezbednosne provere pre nego što budu poslani u skupštinu na glasanje.

3. Kandidati koji odbiju da podlegnu procesu verifikacije bezbednosne provere isključuju se iz konkursa.

### Uz prijavu moraju biti priložena sledeća prateća dokumenta:

- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi; (diplome sa univerziteta iz inostranstva moraju biti nostrifikovane u Ministarstvu obrazovanja, nauke i tehnologije);
- Motivaciono pismo;
- Biografija (CV);
- Dokaz da je državljanin Republike Kosovo;
- Dokaz o radnom iskustvu (priložiti izveštaj Penzionog fonda);
- Dokaz da pravosnažnom sudskom odlukom nije osuđivan za krivično delo.

## PROCEDURA KONKURISANJA

**Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 13. novembra 2023. godine u 16:00 časova.**

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu: Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija za upravljanje ljudskim resursima, N-217).

### Aplikaciju možete uzeti u:

*Šampanoj formi:* na recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosovo, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u  
*Elektronskoj formi:* internet-stranica Skupštine Republike Kosovo - [www.assembly-kosova.org](http://www.assembly-kosova.org)

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana do 16.00 časova, na brojeve telefona: 038 200-10411, 038 200-10410 dhe 044 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz zahtevana dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažecim.



